

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ- Departamenti i Pergjithshem- Divizioni Civil, me gjyqtarin Bekim Salihu dhe bashkëpunëtoren profesionale Fitore Hasani - Ismaili, në çështjen juridike të inicuar me padinë e paditëses [REDACTED] nga Gjilani rr. [REDACTED] [REDACTED] nr. [REDACTED] të cilën e përfaqëson av [REDACTED] nga Ferizaj, kundër të paditurve [REDACTED] [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] të gjithë nga Ferizaj rr. [REDACTED] [REDACTED] në çështjen juridike vërtetim pronësie, në prani të palëve ndërgjyqëse në seancën e mbajtur me datë 19.11.2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- në bazë të pohimit -

- I. **APROVOHET** kërkesëpadia e paditëses [REDACTED] nga Gjilani rr. [REDACTED] [REDACTED] nr. [REDACTED] si e bazuar.
- II. **VËRTETOHET** se paditësja [REDACTED], është pronare e paluajtshmërisë me numër të njësisë kadastrale **P-72217092-00194-3**, me sipërfaqe prej 1522m², Zona Kadastrale Ferizaj, lloji i njësisë "parcelë", në vendin e quajtur "Fushat", pjesa ideale e pronës 46/144.
- III. **OBLIGOHEN** të paditurit [REDACTED] [REDACTED] dhe [REDACTED] [REDACTED] nga Ferizaj, që paditëses të ia njohin të drejtën e pronësisë mbi këtë pronë dhe të i lejojnë regjistrimin e saj në regjistrat kadastral në ZK -Ferizaj, dhe këtë në afat prej 15 ditësh pas pranimit të kopjes së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ky aktgjykim do të i shërbej paditëses si autorizim për të bërë regjistrimin e pronës në emër të saj.
- IV. **OBLIGOHET** paditësja që të paguaj taksën gjyqësore për padi në shumë prej 80€, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Paditësja përmes të autorizuarës së saj me padi si dhe në propozimin për vazhdimin e procedurës ka deklaruar se paditësja, parcelën kontestuese e ka blerë bashkëshorti i paditëses me dt. 22.08.1996, në sip. prej 1522m², në shumë prej 61000DM (marka gjermane), mirëpo paditësja nuk ka mundur ta bartë në tërësi paluejtshmërinë në emrin e saj, pasi që shitësi [REDACTED] [REDACTED] ka vdekur me datën 26.12.2004, ku tani evidentohet si bashkëpronarë me paditësen. E autorizuara e paditëses i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia

e paditëses pasi që të paditurit nuk e kontestojnë të drejtën e pronësisë së paditëses në këtë pronë, kjo nga fakti se të paditurit kanë dhënë deklarata noteriale ku deklarojnë se nuk kanë asnjë pretendim ose interes juridik lidhur me këtë pronë dhe se paditësja është pronare faktike e kësaj prone. Nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

I padituri [REDAKTUAR] në shqyrtimin gjyqësor në këtë qështje kontestimore, ka deklaruar si në deklaratën e dhënë para noterit se nuk e kundërshtoj kërkesë padinë e paditëses dhe se nuk kam asnjë pretendim në parcelën kontestuese 194-3 ZK Ferizaj, dhe se paditëses nuk ia kontestoj të drejtën në pronë për të cilën edhe është duke u zhvilluar procedura kontestimore. Nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Dëshmitari [REDAKTUAR] në deklarin e tij ka theksuar: se në vitin 1996 e kam blerë parcelën në sip. prej 17 ari e 44 m, ku kjo sipërfaqe nuk e ka qenë e ndarë fizikisht por ka qenë në bashkëpronësi të [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] të cilët kanë qenë vëllezër në mes vete. Bartjen e nje pjese të pronës e kam bërë në emër të gruas sime [REDAKTUAR] i, ndërsa pjesa tjetër ka mbetur pa u bartur për arsye sepse unë kam qenë një kohë jashtë vendit dhe se pas vdekjes se të paditurit [REDAKTUAR] këtë nuk kemi mundur ta bëjmë, andaj pasi që edhe tani të paditurit kanë dhënë deklaratë se nuk kanë pretendime ndaj kësaj prone, mendoj se gjithëçka është në harmoni me kontratën e nënshkruar.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve, për aq sa palët ndërgjyqëse parashtruan para gjykatës ka bërë administrimin e provave si vijon: çertifikata e pronës me nr.të lëndës 31158-2018 e dt. 28.03.2018, si dhe kopja e planit , deklarata nën betim me nr.LRP.nr.2391/2018 e dt. 07.06.2018, në emër të [REDAKTUAR] deklarata nën betim me nr.LRP.nr.3526/2018 e dt. 30.07.2018, në emër të [REDAKTUAR], deklarata nën betim me nr.LRP.nr.2399/2018 e dt. 08.06.2018, në emër të [REDAKTUAR], deklarata nën betim me nr.LRP.nr.3527/2018 e dt. 30.07.2018 në emër të [REDAKTUAR], çertifikata e vdekjes me nr. rendor 50, me nr. Ref.19/2005RV/19001, me nr serik V 10134424, e dt. 20.07.2017, dëshmi vdekja në emër të të ndjerit [REDAKTUAR] e dt. 24.10.2017, kontrata mbi shitblerjen e pasurisë së patundshme e vërtetuar ne Gjykatën Komunale në Ferizaj m nr. 2426/03 e dt. 01.10.2003, plotësimi i kontratës mbi shitblerjen e palujtshmërisë e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Ferizaj me nr 3045/06 e dt. 28.07.2006, aktvendimi me nr.protokolli 1556/12 i dt. 30.07.2012, në emër të paditëses [REDAKTUAR]

Gjykata pas analizimit të pretendimeve të paditëses të paraqitura në padi dhe në provat materiale të bashkangjitura në padi si dhe pohimit të kërkesëpadisë nga ana e të paditurve, dëgjimit të dëshmitarit, ka konstatuar se palët mund të disponojnë me të drejtat lidhur me objektin e kontestit dhe se të njëjtat nuk janë në kundërshtim me ligjin apo me rendin juridik, ashtu që duke u bazuar në nenin 148.1 të LPK-së , aprovoi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar me ligj dhe mori Aktgjykim në bazë të pohimit.

Gjykata ka obliguar paditësin që të paguaj e shpenzimet e taksës shtesë për padi në shumë prej 80€ konform Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore lidhur më nenin 450 te LPK-se.

Nga arsyet e theksuara më lartë, e bazuar në nenin 143 dhe 148 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.382/18, me datën 19.11.2018



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROŠEVAC

Më
Dana

12.02 2019

